

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i pergjithshem- dega në Kamenicë, përmes gjyqtarit të vetëm Zijadin Spahiu, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në qështjen penale kundër të akuzuarve H.Z. nga ... dhe A.Z. nga , për shkak të veprës penale në bashkëveprim si bashkëekzekutor keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 parag. 3 lidhur me parag. 1 dhe nenin 23 të KPK-së, ku të akuzuarin H.Z. e përfaqëson me autorizim av. Q.Z. nga , sipas aktit akuzues të Prokurorisë komunale tani Prokurori Themelore – Departamenti për Krime të Përgjithshme në Gjilan, PP.nr.2338/12 të datës 21.11.2012, në shqyrtimin e hapur gjyqësor në prezencën e Prokurores së Shtetit Kujtesa Fazliu, të akuzuarve H.Z. e A.Z. dhe mbrojtësi av. Q.Z. më datën 23.03.2016 shpall publikisht, ndërsa më datën 30.03.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1.I akuzuari **H.Z.**, i lindur më „Data e lindjes„ në fsh. ... , sipas deklaratës së tij i dënuar për vepër penale gjersa nuk udhëhiqet procedurë tjetër për vepër tjetër penale,

2.I akuzuari **A.Z.**, i lindur më „Dat lindja„ në fsh.... , sipas deklaratës së tij i dënuar për vepër penale gjersa nuk udhëhiqet procedurë tjetër për vepër tjetër penale,

Në pajtim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 i KPPRK-së,

LIROHEN NGA AKUZA

Sepse gjatë periudhës kohore nga janari 2008 e gjer më dhjetor 2010, i pandehuri i pare dhe I pandehuri i dytë si person i autorizuar i subjektit ekonomik M.I.M. “Strezovc”, SHPK, me seli në Strezovc dhe Berivojcë, K. Kamenicë, me nr. të regjistrimit të biznesit (NRB) 70350202 me nr. fiscal (NRF) 600136560, për përfitim të dobisë pasurore të kundërligjshëm për organizatën e biznesit, në të cilën kanë qenë të punësuar, i pandehuri i pare si përgjegjës që e ka ditë, se ka detyrim ligjor të paguaj tatimin e përcaktuar me ligj dhe i pandehuri i dytë si përgjegjës i këtij subjekti afarist ekonomik, nuk i kanë paguar mjetet nga detyrimet e tyre tatimore të përcaktuara me ligj, dhe në këtë mënyrë ka dëmtuar Buxhetin e Republikës së Kosovës, në vlerë të përgjithshme prej 80.938,42 €.

-me çka në bashkëveprim si bashkë ekzekutor kishin për të kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 parag. 3 lidhur me parag. 1 dhe nenin 23 të KPK-së.

Shpenzimet e procedures penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore – Departamenti për krime të Përgjithshme, me aktin akuzues PP.nr.2338/12 të datës 21.11.2012, ka akuzuar H.Z. nga ... dhe A.Z. nga fsh.... për shkak të veprës penale në bashkëveprim si bashkëekzekutor keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 parag. 3 lidhur me parag. 1 dhe nenin 23 të KPK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim gjyqësor në të cilën séance kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit Kujtesa Fazliu, të akuzuarit H.Z. dhe A.Z. , mbrojtësi i të akuzuarit H.Z. , av. Q.Z. me autorizim, dëshmitarët A.V. dhe I.K.

Prokurorja e Shtetit Kujtesa Fazliu, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit H.Z. dhe A.Z. t'i shpallë fajtor dhe t'i ndëshkojë sipas ligjit pasi që në bazë të dëgjimit të dëshmitarëve dhe provave të administruara u vërtetua pa mëdyshje se të pandehurit kanë kryer veprën penale në bashkëveprim si bashkëekzekutor keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 parag. 3 lidhur me parag. 1 dhe nenin 23 të KPK-së.

Të akuzuarit H.Z. dhe A.Z. në seancën për shqyrtimin kryesor ashtu edhe në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se nuk pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilën ia vë në barrë në bazë të aktit akuzues, të Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan dhe kanë kërkuar që t'i liroj nga akuza se veprën penale për të cilën akuzohen nuk e kanë kryer e cila u vërtetua edhe nga deklaratat e dëshmitarëve dhe nga ekspertiza e ekspertit financiar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në këtë qështje juridike penale gjykata në cilësi të dëshmitarve ka dëgjuar A.V. , I.K.

Dëshmitari A.V. nga fsh. ... , pasi që është njoftuar për të drejtat e tija si dëshmitar dhe detyrimet nga neni 125 parag. 1 i KPPK-së, dhe neni 392 i të njejtit kod, ka deklaruar: se unë kam qenë në cilësi të ndihmësit të inspektorit të autorizuar të ATK-së, me z. I.K. , dhe me pronarët ka kontaktuar inspektori I.K. dhe unë mundë të flas vetëm në bazë të raportit që ka bërë I.K. dhe unë më tepër e kam pasë rolin formal të anëtarit të komisionit, se lëndën në tërsi e ka përpunuar I.K. , njëherit kam pasë një sëmundje që ka ndikuar që mos ta njoh mire këtë materie.

Në pyetjen e av. Q.Z. , në bazë të dokumentacionit që është në shkresat e lëndës, si mundë të përgjigjeni – të dokumentacionit që është lëshuar tani më dt. 02.03.2015, nga ana e ATK-së, dëshmitari është përgjegjur sipas kësaj gjendja momentale është zero-zero, këta që po e shoh në shkresat e lëndës.

Dëshmitari I.K. nga , pasi që është njoftuar për të drejtat e tija si dëshmitar dhe detyrimet nga neni 125 parag. 1 i KPPK-së, dhe neni 392 i të njejtit kod, ka deklaruar: në vitin 2011 kam qenë inspektor i kontrollës pranë ATK-së, regjionit i Gjilanit, dhe është e vërtetë se rastin e kam pasë si rikontrollë të kompanisë “XIM Strezovc” SHPK dhe periudha e kontrollit ka qenë dhjetor 2010, dhe sa më kujtohet pronar të kompanisë A.Z. ka bërë kërkesë për rimbursim që ti kthehet TVSH-ja, që ka paguar më tepër në vlerë prej 94.687,00 €, kontrollën e ka bërë tjetër kush dhe ATK-ja nuk e ka pranuar si kontrollë dhe Departamenti i kontrollova dhe ankesave, parashtrësën për rimbursim të pandehurve na kanë kthyer lënda në rikontrollë dhe unë me kolegun tim A.V. kemi dale në vendin e ngjarjes, kuptohet me njoftimin paraprak dhe kemi bërë inqizimin e gjendjes faktike, se qka ka investuar në XIM Strezovc, dhe në bazë të raporteve që është në shkresat e lëndës për qdo njësi të SHPK-së Strezovc, për periudhën 2008-2010, duke i mare parasysh të gjitha njësitë punuese të SHPK-së Strezovc, si përpunimin e fraksioneve të ndryshme të gurëve, etj. Dhe në fund kemi konstatuar se tatim paguesit kanë pasë me paguar obligimet

tatimore të këtij lloji, tatimin e vlerës së shtuar apo TVSH-së, 9.915,93 €, pa ndëshkime dhe kamata, për të ardhura personale për punëtor të cilët i ka pasë në punë në tremujorshin e pare deri në muajin mars 2012, që kanë qenë 6.202.47 €, kontributet pensionale, për të njejt

punëtor në bazë të listave dispozuese ka pasë me i paguar 15.784,34 €, lokalin me qira 2008-2009, ka pasë të paguaj 4.065,2 , shuma e kërkuar për rimbursim ka qenë 94.687,90 €, shuma e konstatuar për aprovim për rimbursim ka qenë 59.386,85 €, obligimet të cilat kanë qenë ndaj ATK-së, 35.967 €, shuma e cila duhet mbetur për rimbursim është 24.000,09 €, sipas mendimit tim të pandehurit i kanë vonuar pagesat për të ardhura pensionale për contribute pensionale, tatimin e vlerës së shtuar dhe qira, dhe në fund dëshmitari deklaroi se të pandehurit gjegjësisht ndërmarja XIM Strezovc, si tatim pagues nuk i ka mbetur borgj ATK-së, për asnjë njësi dhe për asnjë formë të tatimit.

Gjykata pas dëgjimit të dëshmitarëve bëri shtjellimin e provave materiale si: ekspertiza e bërë nga eksperti financiar gjyqësor z. R.B., i cili ka pasë për obligim që ta bëjë ekspertizën për periudhën kohore nga janri 2008e gjer në dhjetor të vitit 2010.

Eksperti financiar i caktuar nga ana e kësaj gjykate në lidhje me ekspertizën që ka të bëjë për periudhën kohore nga janari i vitit 2008 e gjer në dhjetor të vitit 2010, për këtë qështje juridike penale ka dhënë mendimin dhe konstatimin e vet me sa vijon:

Të akuzuarit: H.Z. , në cilësinë e drejtorit dhe A.Z. në cilësinë e personit përgjegjës M.I.M. “Strezovci”, me aktivitetin e tyre biznesor për periudhën prej 01.01.2008 gjer më 31.12.2010, kanë qenë në kreditim të TVSH-së, që nënkupton se nuk kanë patur obligime tatimore të pa përmbushura, nëse e marim parasysh qarkullimin e tatim paguesit M.I.M. “Strezovci”, në referim të periudhës tatimore 2008-2010, rrjedh se M.I.M. “Strezovci”, ka deklaruar TVSH-në, në shumën përkatëse por në fund të vitit 2010 nuk e ka paguar shumën e TVSH-së, prej 5.984,65 €, që kjo gjendje nënkupton obligimin por jo edhe shmangie tatimore dhe tatami në burim në shumë prej 460.71 €, dhe kontributi pensional në shumë prej 1.373.65 €, janë deklaruar por nuk janë paguar.

I pandehuri H.Z. në seancën për shqyrtimin kryesor në mbrojtjen e vet ka deklaruar: se nuk e ndien veten fajtor, nuk e ka kryer veprën penale që i vëhet në barrë, pasi nuk kemi pasë obligime as keqpërdorime siq ceket në aktin akuzues, që kjo u vërtetua edhe me ekspertin financiar gjyqësor.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.Z., av. Q.Z. ka deklaruar se nuk është provuar dispozitivi i aktakuzës së ngritur kundër të pandehurit tim dhe me asnjë prove nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet dhe është rast unik që të ndiqet një person që e dëmtuara ka qenë në detyrim ndaj të njëjtit dhe në bazë të gjitha dokumentave të dorzuar në shkresat e lëndës është vërtetuar se i pandehuri nuk ka asnjë detyrim ndaj ATK-së, dhe propozon gjykatës që të njejtin ta liroj nga përgjegjësia.

I pandehuri A.Z. në seancën për shqyrtimin kryesor në mbrojtjen e vet ka deklaruar: nuk e ndi veten fajtor kërkoj nga gjykata që të më liroj nga përgjegjësia se obligimin ndaj ATK-së, i kemi të përmbushura dhe nuk e kam kryer veprën penale që më vëhet në barrë.

Në fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu deklaroi: jemi dëshmitarë se në seancën e deritashme gjyqësore është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe bindëse teza e aktakuzës se të pandehurit kanë kryer veprën penale që u vëhet në barrë sipas kësaj aktakuze, andaj kërkon nga gjykata që ti shpallin fajtor dhe gjatë shqiptimit të denimit të mer parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

I akuzuari H.Z. në fjalën e vet përfundimtare deklaron: kërkoj nga gjykata që të më liroj nga përgjegjësia penale se nuk e kam kryer veprën që më vëhet në barrë që ka vërtetuar edhe ekspertiza e ekspertit gjyqësor financiar.

I akuzuari A.Z. në fjalën e vet përfundimtare deklaron: kërkoj nga gjykata që të më liroj nga përgjegjësia penale se të gjitha obligimet që I kemi pasë ndaj ATK-së I kemi përmbushë.

Gjykata pas dëgjimit të dëshmitarëve, leximit dhe shtjellimit të provave materiale të ekspertizës të ekspertit gjyqësor financiar, deklarimit të prokurores së shtetit, deklaratës së të pandehurve dhe pas fjalës përfundimtare të palëve ka vërtetuar në tërsi gjendjen faktike në bazë të një analize veq e veq të sejcilës prove se për të pandehurit nuk ka prova se kanë kryer veprën penale si është përshkruar në aktin akuzues, e që është vërtetuar edhe në seancën e shqyrtimit kryesor nga deklaratat e dëshmitarëve A.V. , I.K. , dhe ekspertizës së ekspertit gjyqësor financiar R.B. , si dhe prokuroria nuk ka siguruar asnjë prove të vetme që të mundë gjykata të shkoj mbi dyshimin e bazuar se të pandehurit H.Z. dhe A.Z. , kanë kryer veprën penale në bashkëveprim si bashkëekzekutor keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 parag. 3 lidhur me parag. 1 dhe nenin 23 të KPK-së, pasi që në bazë të gjykatës, pas dëgjimit të dëshmitarëve të lartëcekur i gjithë akti akuzues ka qenë i mbështetur në supozim dhe dyshim, por nuk ka mundë të argumentohet me asnjë prove të vetme, prandaj dhe gjykata në pajtim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.1 I KPPRK-së, të pandehurit i ka liruar nga aktakuza, se vepra penale për të cilën akuzohet nuk përbënë veprën penale, që gjykata në rrethana të këtilla duke aplikuar parimin “indubio pro reo” pranoi mbrojtjen e të akuzuarve se ata nuk janë autor të veprimeve të paligjshme, të përshkruara në akuzën e prokurorit public, ngase mbrojtja e tyre nuk është vë në dilemë me asnjë prove nga përfaqësuesi I akuzës dhe gjykata për ate i liroi nga akuzat.

Prandaj kjo veprë penale për tu kryer në frymën e keqpërdorimit të autorizimit në ekonomi, duhet të jetë mashtruese për ti ikur detyrimeve tatimore dhe atyre fiskale, pjesërisht ose tërësisht, e jo thjeshtë për të mos i paguar ato siq është rasti konkret, pasi që disa obligime të pandehurit i kanë deklaruar por nuk i kanë përmbushur dhe ate shuma e pa paguar e TVSH-së 5.984,65 €, tatami në burim në shumë prej 460.71 €, dhe kontribuetet penzionale në lartësi prej 1.373,65 €, janë të deklaruara por nuk janë paguar, prandaj kjo nuk mundë të konsiderohet në frymën e mashtrimit , ikjes së detyrimeve tatimore dhe atyre fiskale të parapar me ligj, prandaj nuk kemi të bëjmë me mos paraqitjen e fakteve të pa vërteta, për të cilat do të caktoj lartësia e detyrimeve apo shuma e rreme, për të cilën duhet paguar në dobi të buxhetit të Kosovës, dhe për të ekzistuar vepra penale edhe për këte është dashtë të ekzistoj dashja direkte për realizimin e qëllimit, prandaj në rastin konkret gjykata ka ardhë në përfundim se nuk ekziston në këtë qështje juridike penale figura e veprës penale, keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, se për obligimet të deklaruara nga ana e të pandehurve që nuk i kanë paguar shteti – ATK-ja ka mundë ti realizojnë nëpërmes të mekanizmave tjerë në procedure të dhunshme, pasi që kemi deklarim të obligimeve nga ana e të pandehurve apo personit juridik atëhere në këtë contest vepra penale nga neni 236 parag. 3 lidhur me parag. 1 dhe nenin 23 të KPK-së, në rastin konkret nuk është në frymën e keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi, pasi që nuk e përfshin elementet e sipërcekura, e që kjo u vërtetua në bazë të dëshmitarëve dhe të ekspertizës të ekspertit gjyqësor financiar.

Prandaj mbrojtja e të pandehurve në këtë qështje juridike penale është në tërsi në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve dhe me provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës, prandaj gjykata erdhi në përfundim se mbrojtja e të pandehurve është e bazuar dhe të

njejtën e vlerësoi drejtë, dhe se të pandehurit nuk kanë kryer veprën penale e cila i`u vihet në barrë sipas aktit akuzues, që kjo u vërtetua në bazë të deklaratave të dëshmitarëve – ekspertizës financiare gjyqësore dhe gjykata ka liruar të akuzuarit nga përgjegjësia penale, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 parag. 3 lidhur me parag. 1 dhe nenin 23 të KPK-së, si dhe të akuzuarit nuk kanë kryer veprime, të kundërligjshme dhe mshefje të elementeve të veprës penale të sipërcekur.

Gjykata duke u mbështetur në dispozitat e nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 të KPRK-së, të akuzuarin ka liruar nga përgjegjësia.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 parag. 1, neni 454 parag. 1 të KPRK-së, bien në mjetet buxhetore të gjykatës.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -DEGA NË KAMENICË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**

Më datën 30.03.2016.

Sekretarja juridike,
Tevide Thaqi,d.v.

Gj y q t a r i,
Zijadin Spahiu,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.